

ESILDA LUKU

SHQIPËRIA DHE SHQIPTARËT NË UDHËPËRSHKRIMET E POLITIKANIT FRANCEZ JUSTIN GODART

821.133.1-992

Abstrakt: Ky punim ka për qëllim të paraqesë opinionin e ish deputetit, ministrit dhe kryebashkiakut të Lionit, Justin Godart, mbi “vendin e shqiponjave” dhe popullin shqiptar në ditaret vetjakë të mbajtur gjatë udhëtimeve të tij në Shqipëri, nga marsi i vitit 1921 deri në dhjetor 1951.

Nëpërmjet hermeneutikës klasike dhe analizës historike të veprave të J. Godart “Shqipëria më 1921” dhe “Ditarët shqiptarë”, artikujve të botuar në shtypin francez, si dhe vlerësimeve të studiuesve shqiptarë ndaj mikut të Shqipërisë, punimi synon të evidentojë interesin e politikanit francez mbi natyrën, resurset ekonomike, zhvillimet politike, kulturën, fenë dhe marrëdhëniet sociale. Gjithashtu, një vend të rëndësishëm në rrëfimet e tij zënë takimet me personalitetet shqiptare, si: Ahmet Zogu, Fan Noli, Gjergj Fishta, Bajram Curri, Luigj Gurakuqi etj.

Analiza e udhëpërshkrimeve dëshmon shërbimin e senatorit francez në mbrojtje të çështjes kombëtare, kontributin e tij për pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, themelimin e misionit arkeologjik francez në Shqipëri, nën drejtimin e Leon Rey, si dhe krijimin e lidhjes kulturore shqiptaro-franceze.

Fjalët kyçe: *udhëpërshkrime, bukuria natyrore, qëndrueshmëria kolektive, patriotizmi, mikpritja familjare.*

Hyrje

Personaliteti i njohur dhe një ndër figurat më të spikatura të Republikës së Tretë në Francë, Justin Godart (1871-1965), ishte jo vetëm një mendimtar i lirë, humanist dhe laik, por edhe një njeri i veprimit në mbrojtje të popujve dhe vendeve që vuanin nga padrejtësitë e kohës.¹ Karriera e tij profesionale shënoi një kthesë të rëndësishme me mbrojtjen e doktoraturës në drejtësi, më 1899, me temën “Punëtori i mëndafshit. Monografi për endësin lionez. Një studim historik, ekonomik dhe shoqëror” dhe dy vite më vonë, ai u bë docent në Fakultetin e Drejtësisë. Justin Godart u angazhua në jetën politike, më 1906, kur u zgjodh deputet i Lionit dhe, në vitet 1927 – 1940, ishte anëtar i Senatit francez. Ai kreu një sërë funksionesh me rëndësi, si: nën Sekretar Shteti për Shëndetësinë Ushtarake (1915-1918), Ministër i Punës dhe i Higjienës (1924-1925), Ministër i Shëndetësisë (1932-1933). Ai themeloi Lidhjen Ndërkombëtare kundër Kancerit me qendër në Paris, më 1934, dhe u pranua në Akademinë Kombëtare të Mjekësisë (1939) falë punës së tij në fushën e shëndetit publik. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, J. Godart mori pjesë në Rezistencën Antifashiste (1940-1944) dhe, në shtator 1944, u bë Kryetar i Bashkisë së qytetit të sapo çliruar të Lionit.² Për kontributin e tij shumëplanësh, brenda dhe jashtë vendit, ai u vlerësua me urdhra dhe medalje të shumta, si: Legjioni i Nderit, i Drejti midis Kombeve, madje, edhe qeveria shqiptare, më 1937, i akordoi “Urdhrin e Skënderbeut”.³

¹ Asti Papa, “Justin Godart dhe At Gjergj Fishta”, *Gazeta Shqiptare*, Nr. 6030, 16 qershor 2016, f. 16

² Justin Godart. *Ditarët shqiptarë: shënimet e udhëtimeve nga marsi 1921 deri në dhjetor 1951*. Tiranë: Dituria, 2008, f. 7-12

³ Fotaq Andrea, “Justin Godart, mik i madh i kombit shqiptar”, 23.06.2012, http://www.zemrashqiptare.net/neës/id_28133/rp_0/act_print/1/Printo.html

Justin Godart e vizitoi për herë të parë Shqipërinë në prag të Luftës së Parë Botërore, në kuadër të misionit të drejtuar nga z. D'Estournelles de Constant, i cili ishte kontraktuar nga Fondacioni Carneige në New York për të kryer hulumtime në lidhje me disa aspekte të luftërave ballkanike.¹ Në gusht 1916, deputeti i Lionit përshkoi territorin shqiptar gjatë itinerarit për në Armatën franceze të Lindjes në Selanik.² Për të plotësuar anketën ballkanike, J. Godart do ta vizitonte sërish Shqipërinë për të qëndruar më gjatë në vitet 1921, 1922, 1923, 1937 dhe 1951. Gjatë udhëtimeve të tij në qytetet shqiptare, politikani francez mbajti shënime të shumta në ditarët vetjake, të pajisura me fotografi dhe letërkëmbime me personalitetet shqiptare të kohës. Këto burime u bënë të njohura për publikun shqiptar vetëm si rezultat i punës së nipit të tij, François Bilange, që deshifroi dhe zbardhi shënimet me shkrim të imët dhe plot shkurtime të senatorit Godart.³

Publikimi nga Shtëpia Botuese “Dituria” i ditarëve të Godart-it, të mbajtura gjatë udhëtimeve të tij në Shqipëri, në periudhën mars 1921- dhjetor 1951, është vetëm njëra nga veprat e ish deputetit francez për “vendin e shqiptarëve”. Më 1922, ai botoi në Paris librin “Shqipëria në 1921”, me 378 faqe, që i dedikohet gjendjes politike në Shqipëri, qëndrimeve të Fuqive të Mëdha e fqinjëve ballkanikë dhe sfidave të ardhshme të shtetit shqiptar.⁴ Të tjera publikime të Justin Godart-it për Shqipërinë janë: *Albanie. Impressions de voyage en Albanie (Shqipëria. Përshtypjet e udhëtimit në Shqipëri)*. – Në: “Cahiers de Droits de l'Homme” (“Fletore për të Drejtat e Njeriut”), Paris 1921, f. 349-350; *L'Albanie à la foire de Lyon (Shqipëria dhe Panairi i Lionit)*. – Në: “Lyon”, No. 13, 1921, f. 4-5; *L'Albanie en 1922 (Shqipëria në 1922)*. – L'Enquête de la Société des Nations, Bulletin Trimestriel (Anketa e Lidhjes së Kombeve, Buletini Tremujor), No. 1, La Flèche (Sarthe), 1922, f. 70; *La langue française en Albanie (Gjuha frënge në Shqipëri)*. Në: “Nôtre langue dans le Bassin de la Méditerranée” (“Gjuha jonë në pellgun e Mesdheut”), Paris, 1923, f. 96-97; *Albanie (Shqipëria)*. – Në: “Revue de l'Enseignement Français” (“Shqyrtimi i mësimdhënies franceze”), Paris, 1922, No. 38, f. 87-91.⁵ Gjithashtu, senatori Godart ka qenë mjaft aktiv në shtypin francez me artikujt e botuar për Shqipërinë, shumica e të cilëve janë përkthyer dhe publikuar edhe në periodikët shqiptarë të kohës, si: “Shqipëria dashuron Francën”, *Drita*, 3 qershor 1921; “Shqipëria dhe Italia”, *Drita*, 18 korrik 1921; “Kujt i përket monastiri i Shën Naumit? Shqypnies? Serbies?”, *Elbasani*, Nr. 26, 26 vjesht e I, 1923, etj. Këto shkrime mbartin vlerë të posaçme jo vetëm se e bënë Shqipërinë të njohur në opinionin francez dhe më gjerë, por mbi të gjitha shërbyen si thirrje drejtuar faktorit ndërkombëtar në mbrojtje të çështjes shqiptare.

“Shqipëria në 1921” sipas Justin Godart

Vepra e Godart-it “Shqipëria në 1921” botuar nga Les Presses Universitaires de France, më 1922, përbën një vlerë të shtuar për historiografinë shqiptare. Ajo nis me parathënien prej 26 faqesh të senatorit D'Estournelles de Constant i cili, në rrëfimin e tij të sinqertë, shkruan: “Kam një hua të madhe drejt Shqipërisë, dhe dua të pagonj një pjesë të kësaj huaje që i kam nga koha kur isha i ri”. Ai i referohet pranverës së vitit 1879, kur, në pozicionin e sekretarit të Komisionit të caktimit të kufijve të Shqipërisë Veriore u bë pjesë e padrejtësisë evropiane që shkëputi Podgoricën, Shpuzën, Tivarin dhe Ulqinin nga

¹ Fotaq Andrea, “Justin Godari: Shqipëria më 1921”, 1 Gusht 2012, <http://www.nacionalalbania.al/2012/08/fotaq-andrea-justin-godari-shqipëria-me-1921/>

² Luan Rama. “Godar: një miqësi e vjetër”, *Korrieri*, Nr. 91, 21 prill 2005, f. 19

³ At Gjergj Fishta... në “Ditarët” e Justin Godart, <http://www.radiandradi.com/at-gjergj-fishta-ne-ditaret-e-justin-godart/testata-kryesore/gazeta/>, available on 22.09.2017

⁴ Justin Godart. *Shqipëria në 1921*. Tiranë: Klubi i Poezisë, 2015

⁵ J. Godart, *Ditarët shqiptarë...*, f. 2

viset shqiptare në favor të Malit të Zi.¹ Copëtimi i kombit shqiptar i dha mundësi z. Constant të shohë dritën e së vërtetës dhe të punojë pa pushim në të mirë të paqes dhe qetësisë në botë, dhe po ashtu, të llobojë për të drejtat e Shqipërisë. Si mik i popullit shqiptar, ai nuk i kursen as këshillat për ta, teksa pohon se: “Qetësia dhe rregulla mvaret nga urtësi e Shqiptarëve. Sa më vjen keq që nuk mund të vete në Shqipëri dhe të vë në shërbim të saj një pjesë të vullnetit të mirë dhe të eksperiencës që kam akoma”.²

Parathënia nga D’Estournalles de Constant ndiqet nga Kapitulli i parë në të cilin Godart rreshton një varg argumentash dhe gjykimesh mbi origjinën e shqiptarëve, duke treguar me dokumente veçantinë e kombit shqiptar, bazuar në shënimet e shkrimtarëve më në zë francezë, si: De Lavardin, Ami Boué, P. Duponcet etj.³ Më tej, autori me një gjuhë të rrjedhshme jep përshtypjet mbi udhëtimin e tij në qytetet e ndryshme të Shqipërisë gjatë periudhës mars-maj 1921, duke i konsideruar ato në një gjendje më të mirë se sa e kishte parashikuar. Ky perceptim i tij buronte nga fakti se “Shqipëria ka qenë e shkelur dhe e pushtuar nga ana e kombeve të mëdha, të cilat mendonin vetëm si të përfitonin prej saj. Por, populli shqiptar nuk iu nënshtrua fatit të keq dhe mundi të ruajë me zili nderin e tij, karakterin kombëtar e gojëdhënat, dhe, për më tepër, asnjëherë patriotizmi i tij nuk ka munguar”.⁴

Senatori Godart bën një rezymë të rrugëtimit të shqiptarëve për të fituar autonominë dhe më pas pavarësinë, si dhe të përpjekjeve për konsolidimin e shtetit shqiptar. Ai e nis trajtesën me reagimin e shqiptarëve ndaj Revolucionit xhonturk (korrik 1908), kryengritjet shqiptare të viteve 1908-1912, shpalljen e pavarësisë dhe qëndrimin e Fuqive të Mëdha, regjimin e shkurtër të Princ Vidit (mars-shtator 1914), për të cilin nuk gjen një fjalë të vetme simpatie. Godart përshkruan kujtimet e bashkëkohësve, të cilët tregonin se si “në kohën e hyrjes së tij në Tiranë, ai (Princ Vidi, E.L) zbriti nga kali dhe nxitoi të shkonte, duke mbajtur yzengjinë, për të ndihmuar princeshën të zbresë; pastaj e kaloi atë përpara tij me shumë nderime. Ky gjest i tij u vlerësua me shumë sinqeritet dhe shumë përbuzje nga populli. Ata shpjegonin se një mbret duhet të ecë përpara, se në qoftë se nuk është mbreti i gruas së tij, si mund të jetë i një kombi”.⁵

Më pas, filoshqiptari Godart përmend Kryengritjen e Shqipërisë së Mesme dhe shpërthimin e Luftës së Parë Botërore, duke analizuar veçanërisht figurën komplekse të Esat Pashë Toptanit, që e cilëson “një aventurier që, kur vendi i tij përpëlitej në vështirësi të mëdha, donte t’u uzurponte me intrigat dhe ndihmën e të huajve, një autoritet që Shqipëria nuk e njohu kurrë”.⁶ Ai shtjellon në vijim pushtimin austro-hungarez, francez dhe italian të Shqipërisë gjatë Luftës së Madhe, politikën e brendshme dhe të jashtme të Qeverisë së Përkohshme të Durrësit dhe asaj të Tiranës, nën drejtimin e Sulejman Delvinës, zgjedhjet e para parlamentare në vend, pa harruar të theksojë seancën që u mbajt për nder të tij në Parlamentin shqiptar, më 30 prill 1921.⁷

Krahas historisë politike të Shqipërisë, ish deputeti Godart jep të dhëna mbi numrin e popullsisë, situatën ekonomike, nivelin arsimor dhe marrëdhëniet shoqërore.⁸ Ai ndalet të përshkruajë me detaje statusin e femrës shqiptare, të drejtat civile dhe sociale të saj. Mikut të shqiptarëve i bën përshtypje se si ardhja në jetë e një vajze pritet me zhgënjim në familje; mungesa e lirisë së saj për të zgjedhur në martesë; izolimi i gruas myslimane në qytetet ku dominojnë zakonet turke, por edhe vlerësimi i saj “si zonjë e shtëpisë” në pozitën e nënës, duke veçuar mbi të gjitha sigurinë që të fal udhëtimi i shoqëruar nga një grua. Ai

¹ “L’Albanie en 1921”, Paris, 1922. Rec. Shqypnija e miqt e sajë”, *Hylli i Dritës*, Nr. 3, Mars 1922, f. 131

² Lumo Skëndo, “Duke kënduar një libër: L’Albanie et les Albanias en 1921”, *Dodona*, Nr. 2, Shkurt 1922, f. 29

³ Criticus. “Tue i hjedhë një sy librit të z. Godartit “Shqypnija në vjetin 1921”, *Agimi*, Nr. 10, Shkurt 1922, f. 197

⁴ “Çë tha Z. J. Godart-i”, *Mbrojtja kombëtare*, Viti 11, Nr. 31, Vlorë, e martë, 19 Prill 1921, f. 2

⁵ J. Godart, *Shqipëria në 1921...*, f. 105-106

⁶ *Ibid.*, f. 107

⁷ Justin Godart, “Tregim dashamirsisje bujare. Shqypnija e don Francën”, *Agimi*, Vjeti III, Nr. 2, Shkodër, Qershor 1921, f. 27

⁸ “Bibliografia”, *Hylli i Dritës*, Nr. 11, Nëntor 1922, f. 552

shkruan: “Në fiset myslimane, si në fiset katolike, gruaja shihet si një qenie e shenjtë; ajo mund të udhëtojë në të gjithë vendin, ditën dhe natën, pa patur frikë as nga ndonjë fyerje, as nga ndonjë rrezik; në luftërat vdekjeprurëse ndërmjet fiseve, ajo është e sigurt duke qenë gjithmonë e falur nga pushka armike. Fajtori i rrezikuar nga hakmarrja kur ndodhet pranë një gruaje nuk vritet kurrë. Për të qënë i ruajtur, një thesar i besohet një gruaje; kushdo qoftë ajo, ky thesar është i sigurt”.¹

Një çështje tjetër me rëndësi në librin e J. Godart-it është roli i besimeve fetare në bashkimin kombëtar. Shqiptarofili Godart shpreh bindjen se patriotizmi është e para fe; se shqiptarët e ndajnë besimin nga kombësia dhe janë të gatshëm të përqafojnë një fe të re nëse ajo i shërben interesave kombëtare. Ai tregon se si autoritetet austriake, greke e turke përdorën respektivisht katolicizmin, ortodoksinë dhe islamin si mjete të propagandës politike. Por kjo taktikë nuk e çënoi bashkëjetesën dhe tolerancën fetare ndër shqiptarët,² fakt që evidentohet në martesat midis individëve që i përkasin religjioneve të ndryshme. Godart perfrazon thënien e një mësuesi të vjetër se shqiptarët nuk janë fetarë, duke e provuar me argumentin se betimi nuk formulohet në emër të Zotit, por për qiellin, tokën, dritën dhe zjarrin. Ky arsyetim përgënjeshtrohet në recensën e botuar për veprën e J. Godart “Shqipëria në 1922” në revistën “Hylli i Dritës, nr. 3, mars 1922, si një paradoks që prej themeli, sepse shqiptarët kanë qenë gjithmonë fetare dhe e kanë mëse të qartë idenë e Zotit, Krijuesit të tyre.”³ Më tej, politikani francez thekson se liberalizmi i madh i shqiptarëve në çështjen e fesë i shërbente bashkimit të të gjithë elementeve të kombit kundër shtypjes së huaj. Ai i atribuon bektashizmit po ashtu një ndikim pozitiv në harmoninë fetare të shqiptarëve, duke e përmbledhur rëndësinë e kësaj doktrine në fjalët e Baba Sulejmanit: “Ne duam paqen në botë dhe të mirën e njerëzimit. Ne punojmë për të dëbuar fanatizmin dhe jemi miqtë e besimtarëve të sinqertë të të gjitha religjioneve”.⁴

Ish nënkryetari i Parlamentit francez rrëfen me entuziazëm në Kapitullin IV edhe aftësinë e shqiptarëve për t’u organizuar dhe për të krijuar një qeveri, autoriteti i së cilës njihet në mbarë territorin e vendit. Shqipëria e drejtuar nga Këshilli i Lartë prej 4 anëtarësh dhe nga një kabinet me 6 ministra po punon për hartimin e një Statuti me frymë demokratike.⁵ Godart e plotëson parashtrësën e tij mbi gjendjen politike të Shqipërisë në gjysmën e parë të vitit 1921 me statistika mbi ushtrinë, xhandarmërinë, pushtetin gjyqësor, situatën financiare, problemet shëndetësore, sistemin arsimor etj.

Sipas J. Godart-it, ashtu sikurse historia e brendshme e Shqipërisë është për nder dhe nam të popullit të saj, që diti të ruajë kombësinë dhe pjesën më të madhe të tokës së vet; kështu edhe historia e jashtme e saj është shkruar në dokumentet diplomatike të Fuqive të Mëdha, në të cilat Shqipëria përdoret si monedhë këmbimi. Miku i shqiptarëve nuk ngurron të nxjerr në pah kompromiset e të mëdhenjve, gjyqet e pashpirtra, traktatet e fshehta në kurriz të kombit shqiptar.⁶ Ai analizon mbi bazën e fakteve të pakontestueshme se shpëtimi i Shqipërisë prej copëtimit erdhi si rrjedhojë vetëm e intrasigjencës kalorsiake dhe burrërore të ish presidentit të SHBA-së, W. Wilson, i cili e mbrojti çështjen shqiptare para Konferencës së Paqes në Paris, sidomos kundër përfaqësuesve të Aleatëve, me një shpirt drejtësie dhe humaniteti të lartë.⁷

Përpos shqyrtimit të politikës së Fuqive të Mëdha, në Kapitullin VI, VII dhe VIII, filoshqiptari Godart paraqet interesat e Italisë, Jugosllavisë dhe të Greqisë kundrejt shtetit shqiptar. Fqinji i përtej Adriatikut

¹ J. Godart, *Shqipëria në 1921...*, f. 94

² J. Godart, “Shqipëria e dashuron Francën”, *Drita*, 5 qershor 1921

³ “L’Albanie en 1921”, Paris, 1922. Rec. Shqypnija e miqt ..., *Hylli i Dritës*, f. 133-134

⁴ J. Godart, *Shqipëria në 1921...*, f. 143

⁵ Justin Godart, “Shqipëria ushqen dashuri për Francën”, *Jet’e Re*, 30 Qershor 1921

⁶ “L’Albanie en 1921”, Paris, 1922. Rec. Shqypnija e miqt ..., *Hylli i Dritës*, f. 134

⁷ Criticus. “Tue i hjedhë një sy librit të z. Godartit...”, f. 198

kërkonte me çdo kusht zotërimin e ishullit të Sazanit, për arsye gjeostrategjike. Mbretëria Serbe-Kroate-Slllovene refuzonte të tërhiqte ushtrinë e saj nga territoret në veri dhe verilindje të Shqipërisë, ndërsa Athina zyrtare vijonte me insinuatat me qëllim aneksimin e Korçës dhe të Gjirokastrës. Këto synime territoriale të fqinjëve morën fund me vendimin e 9 nëntorit 1921 të Konferencës së Ambasadorëve në Paris që rikonfirmonte kufijtë e Shqipërisë politike të 1913-ës me disa rektifikime të vogla, si shkëputja e një pjesë të krahinës së Lumës, Hasit dhe të Gollobordës, të banuara nga popullsi shqiptare, në dobi të Jugosllavisë.¹

J. Godart shtjellon në vijim rrethanat dhe faktorët që kushtëzuan pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve dhe në një kapitull të veçantë përcjell vuajtjet e shqiptarëve nga tokat e shkëputura padrejtësisht prej vendit mëmë, si rrjedhojë e lojrave diplomatike të shteteve të mëdha, të cilët e përdorën Shqipërinë si plaçkë, duke e shitur dhe duke e blerë sipas qejfit të Fuqive fituese dhe dallavereve tinzare të fqinjëve. Analizën e sjelljes së faktorit ndërkombëtar ndaj Shqipërisë, senatori francez e plotëson me 32 fotografi, 3 harta etnografike, një hartë që tregon fshatrat e djegura prej grekëve në Shqipërinë jugore etj.²

Vepra e Justin Godart, që dallohet për paanësinë, guximin për të thënë të vërtetën, pa marrë parasysh konsideratat politike, duke e trajtuar çështjen nga perspektiva thjesht shqiptare, mbyllet me një apel drejtuar Fuqive të Mëdha, të cilat përgjegjëse për gjendjen e Shqipërisë, kanë për detyrë ta ndihmojnë atë. Godart përshkruan shkatërrimet e mëdha të lëna nga Greqia, Serbia, Austria dhe Italia që, cilindo vend, do ta kishin zhytur në anarki. Por, Shqipëria, megjithatë, arriti të rezistonte, duke ruajtur rregullin në vend. Ai shkruan: “E plagosur, e lënduar, ajo qëndron e palëkundur, me krenari gjatë shekujve të gjatë të rezistencës së saj, nga papajtueshmëria patriotike që gjithmonë, nuk e ka lejuar atë, veçse të zgjedhë alternativën ndërmjet vdekjes dhe lirisë. Por, në të vërtetë, është Shqipëria që duhet të akuzojë për t’u thënë Fuqive të Mëdha: “Ju më keni shtypur, ju më keni rrënuar, ju më keni ndarë, Jeni ju që grindeni për të copëtuar tokën time dhe jeni ju që guxoni të më adresoni qortime!” Ndaj Shqipërisë, Fuqitë e Mëdha përmbushën një vepër të ndershme shlyerjeje. Ato i janë moralisht borxh asaj”.³

Shqipëria në ditarët e Justin Godart

Libri “Ditarët shqiptarë” i ish-ministrit francez, Godart, i përgatitur për botim nga nipi i tij, François Bilange, dhe i shqipëruar nga Asti Papa, u bë i njohur për lexuesin fale publikimit të Shtëpisë Botuese “Dituria”, më 2008. Kjo vepër i përngjan një albumi, ku natyra dhe peisazhet përshkruhen me fuqinë e fjalës, ngjarjet politike paraqiten me forcën e argumentit, dialogjet me personazhe të ndryshme, qoftë njerëz të thjeshtë apo elita politike e kohës jepen me realizëm. Në shënimet mbi tetë udhëtimet e tij në Shqipëri, në periudhën 22 mars 1921 – 26 dhjetor 1951, Godart përmend fshatrat dhe qytetet që vizitoi, emrat e njerëzve që takoi dhe gjykimet mbi to, historitë e treguara, të dhëna mbi zhvillimet politike, situatën financiare, sistemin arsimor, shërbimin shëndetsor në vend, si dhe marrëdhëniet me shtetet e tjera, veçanërisht me fqinjët, dhe kërkesat për mbështetje nga ana e qeverisë franceze.

Gjatë udhëtimit të parë kryq e tërthor Shqipërisë, më 22 mars – 13 maj 1921, deputeti i Rhones, J. Godart, zbuloi një vend të mrekullueshëm malor, qytete me piktoresk të pakrahasueshëm, brigjet më të bukura të Adriatikut dhe një popull besnik dhe të denjë për miqësinë me Francën.⁴ Në ditarin e tij, ai rendit njerëzit që takoi dhe përshtypjet për to, si: diplomatin filoitalian Stefë Curani; politikanin pragmatist Dr. Mihal Turtulli; ish-ministrin Rauf Fico; deputetin e Matit, shumë aristokrat dhe me ambicie të ftohtë Ahmet

¹ J. Godart, *Shqipëria në 1921...*, f. 187-251

² L. Skëndo, “Duke kënduar një libër...”, f. 27-28

³ J. Godart, *Shqipëria në 1921...*, f. 287

⁴ Justin Godart, “Shqipëria dhe panairi i Lionit”, *Expansion Commerciale*, Nr. 13, Korrik 1921, f. 4

Zogu; mësuesin e devotshëm Mati Logoreci; “Homerin e Shqipërisë” At Gjergj Fishta etj. Me këtë të fundit, miku i shqiptarëve zhvilloi disa takime dhe bisedoi për çështje të ndryshme. Françeskani i shpjegonte diversitetin midis krahinave shqiptare, që do të zhdukej brenda dy brezave dhe që nuk buronte nga besimet fetare, por nga kulturat e ndryshme që ato përçojnë. Ai i fliste për tolerancën dhe harmoninë fetare ndër shqiptarët, duke i treguar se nëpër fshatra myslimanët shkonin për Pashkë para Kishës dhe prisnin katolikët kur dilnin nga mesha për të festuar së bashku. Kjo sjellje e hijshme u shpërblehej nga katolikët, madje edhe me të shtëna pushkësh, kur myslimanët dilnin nga Xhamia për Bajram. Deputeti i Shkodrës arsyetonte prapambetjen e qytetërimit shqiptar me politikën e Turqisë për të penguar çdo përparim, duke e lënë vendin pa infrastrukturë, pa shkolla, pa kulturë, ndonëse në popull vërehej një inteligjencë e madhe.¹ Ndaj, poeti i kërkonte Godart-it që Akademia Franceze të drejtonte kulturën shqiptare dhe kërkimet historike. Por, ai kundërshtoi propozimin e senatorit francez që një kongregacion fetar të vinte për të hapur shkolla në Shqipëri, me argumentin se arsimit fillor dhe i mesëm i përkiste vetëm shqiptarëve, ndërsa francezët mund të kontribuonin në arsimin e lartë dhe atë teknik,² qëndrim që dëshmonte patriotizmin e thellë të publicistit Fishta.

Po ashtu, në shënimet për udhëtimin e tij të parë në Shqipëri, Godart, përshkruan me detaje relievin e qyteteve që vizitoi, historikun, stilin arkitektonik dhe zhvillimin urban të tyre. Për kryeqendrën e veriut, ai shkruan: “Shkodra gjatë shekujve dhe deri tani vonë ka qenë sulmuar e pushtuar nga ushtri të huaja, që kanë vjedhur e shkatërruar, kështu që kanë mbetur fare pak monumente nga e kaluara e saj. Ajo ka pasur fatin e keq që të shohë qytetërime të ndryshme, të cilat në vend që t’i mbivendosin të mirat e tyre, kanë menduar vetëm që të rrënojnë ato që kishin lënë të tjerët. Kësisoj romakët, venedikasit, turqit, malazezët, serbët, austriakët kanë lënë vetëm aq pak kujtime në historinë e Shkodrës sa që nga kjo të nxjerrim përfundimin mbi qëndresën e pamposhtur të shpirtit shqiptar, i cili ka mbijetuar dhe triumfuar”.³ Beratin, ai e cilëson, “qytetin e njëmbinjë dritareve, sepse asnjë fasadë shtëpie nuk fshihet nga një banesë tjetër. Shtëpitë janë shumë të vjetra. Disa banesa janë piktoreske dhe të lënë pa mend”. Nëse Beratin e quan qytetin e dritareve, Gjirokastrën e etiketon si qytetin e çatave. Sipas Godart-it, “ajo zotëron një kështjellë hijerëndë dhe shtrihet mbi 3 kodrina më të ulëta, në rrëzë të një shpati të thyer e të zhveshur të malit, të çarë me gryka të thella nga rrjedhat e përrënjeve. Gjirokastra duket si qyteti më tipik shqiptar nga arkitektura dhe fryma e saj”.⁴

Një vend të veçantë në përshkrimet e Godart-it zë edhe mikpritja e banorëve të qyteteve dhe fshatrave shqiptare, të cilëve ai iu shpreh mirënjohjen. P.sh., vizita e filoshqiptarit në Vlorë, më 13 prill 1921, u karakterizua nga pritja solemne dhe entuziazmi i madh. Një pjesë e konsiderueshme e banorëve kishin dalë në Shesh të Pashait, ku ziente kënga, kërciste vallja dhe dëfrimi valonte në zemrat e të gjithëve. Vajzat dhe djemtë e shkollave i uronin mirëseardhjen me fjalë të ngrohta dhe duartrokitje. Ndërsa, përfaqësuesi i Shoqërisë “Mbrojtja Kombëtare”, Sezai Çomo, mbajti fjalimin e mëposhtëm në gjuhën frenge për nder të Justin Godart-it:

“I shkëlqyeri Godart,

Mburemi të kemi sot në gjirin tonë, një nga më të shquarit shqiptarofilë.

Gjithë Vlora dhe Sazani, gjithë kjo natyrë arbërore gëzon fytyrën tuaj të ëmbël.

Jemi lindur të adhurojmë miqtë idealë që vizitojnë tokën tonë.

¹ J. Godart, *Ditarët shqiptarë...*, f. 17-100

² Besi Bekteshi, “Dedikimi i gjetur i Justin Godart për Fishtën, ose francezi i pasionuar me Shqipërinë”, *Sot*, 26 Shtator 2013, f. 16

³ J. Godart, *Ditarët shqiptarë...*, f. 31

⁴ J. Godart, *Ditarët shqiptarë...*, f. 50; 62

Mund të kemi shumë të meta në krahasim me Oksidentin; po faj nuk kemi, se deri dje ishim nën despotizëm.

Po mos u dëshpëroni se në zemrat tona vazhdon edhe ajo besa e vjetër shqiptare.

Në këto brigje që shihni rrëzuar të huajtë më gjithë atë trimërinë që treguan francezët e '89-s të Marnit dhe të Verdunit.

Dhe sot, mik i dashur i ynë, gëzojmë të lirë fytyrën e vlefshme albanofile.

Pritni të falat tona zot i shquar, ju dhe gjithë populli i Francës, që në disa raste u dëftua fisnike kundrejt nesh këto kohët e fundit dhe për këtë i jemi mirënjohës.

Vazhdoni i shkëlqyeri Godart në miqësinë që keni kundrejt nesh sepse e meritojmë, sikurse meritoni ju nderimet tona.

Emri juaj në këtë vizitë u rrënjos përgjithmonë në zemrat tona.

Pra thërrasim me zemër,

Rroftë populli i Francës,

Rroftë miku ynë Godart¹

Ish nën-kryetari i Parlamentit francez mbeti i mahnitur nga pritja e popullit të Vlorës dhe takimet dashamirëse që pati në Prefekturë, në Shoqërinë “Mbrojtja Kombëtare” dhe në Spitalin e qytetit. Ndërsa katundaria shtroi një darkë për nder të filoshqiptarit Godart, gjatë së cilës mbajtën fjalën e rastit disa personalitete shqiptare, ndër to edhe deputeti i Korçës, Pandeli Evangjeli. Ai, midis të tjerave, theksoi mirënjohjen e pakufishme për ndihmën e madhe që Justin Godart dha në çastet më kritike të jetës politike të Shqipërisë. Falë kontributit të tij, kombi i vogël shqiptar fitoi të drejtën të jetojë i lirë dhe i pavarur.²

Jo vetëm elita politike, por mbarë populli shqiptar i shprehte mirënjohjen deputetit francez për rolin e tij në mbrojtje të çështjes shqiptare. Godart pati mirësinë t'i drejtoj një mesazh Kryetarit të Lidhjes së Kombeve, që influencoi pozitivisht për anëtarësimin e Shqipërisë me të drejta të plota në këtë organizatë.³ Për më tepër, ai nuk ngurroi që nëpërmjet shkrimeve të tij në të përditshmet franceze të evidentojë praninë e ushtrisë serbe në një pjesë të territorit shqiptar, si dhe shkeljet e kërcënimit e grekëve që turbullonin qetësinë e Shqipërisë së Jugut.⁴ Majde, i pyetur nga një korrespondent amerikan mbi vërtetësinë e artikujve të gazetave të huaja se në Korçë shqiptarët kishin vlarë 20 grekë, deputeti Godart e mohoi këtë lajm, duke arsyetuar se në Korçë nuk ka asnjë grek.⁵

Avokatia dhe lobimi për çështjen shqiptare shkoi deri aty sa, pa u trembur, politikani francez nxori në pah paaftësinë e Lidhjes së Kombeve për të trajtuar kërkesën e qeverisë shqiptare bazuar në nenin 10 të Statutit që, sipas të drejtave të konstatuara dhe të kontrolluara nga një Komision hetimor, të përcaktohej kufiri brenda të cilit, përfundimisht, të mund të zhvillohej veprimtaria kombëtare. Për fat të keq, të mëdhenjtë po punonin për t'ia çuar kërkesën e Shqipërisë Konferencës së Ambasadorëve në Paris. Kështu, nga Gjykata e lartë e paanëshme dhe publike e Lidhjes së Kombeve, çështja do zbritej në një mbledhje diplomatësh me dyer të mbyllura, të gatshëm për marrëveshje të fshehta dhe kompensime. Kjo ishte një vendimarrje tërësisht e padrejtë sepse si anëtare e Lidhjes së Kombeve, Shqipëria kishte mundësi të dëgjohej, kurse, përpara Konferencës së Ambasadorëve, ajo do të mungonte, pasi qeveria e saj nuk ishte njohur ende.⁶

¹ “M.J. Godard-i në Vlorë”, *Mbrojtja Kombëtare*, Nr. 30, Vlorë, E enjte, 14 Prill 1921, f. 3-4

² “Çë tha Z. J. Godart-i...”, f. 2

³ J. Godart, *Ditarët shqiptarë...*, f. 217

⁴ Justin Godart, “Shqipëria është viktimë e një padrejtësie”, *Le Matin*, 1 Korrik 1921

⁵ “Godard-i për Korçën shqiptare”, *Mbrojtja Kombëtare*, Nr. 35, Vlorë, E hënë, 23 Maj 1921, f. 1

⁶ Justin Godard, “Shqipëria dhe Italia”, *L'Ere Nouvelle*, 22 Qershor 1921

Godart, gjithashtu, pas kthimit në Paris, në përfundim të udhëtimit 5 javësh në Shqipëri, më 24 maj 1921, i drejtoi një letër Kryeministrit të Francës, Aristide Briand. Pasi bënte një rezymë të gjendjes së përgjithshme politike dhe karakterit të popullit shqiptar, ai i kërkonte qeverisë franceze ta përkrahte pa mëdyshje Shqipërinë, qëndrim që ishte madje edhe në interesin e fqinjëve të saj. Sipas tij, nëse francezët do të duan, “Shqipëria do të jetë në Ballkan një element stabiliteti dhe përparimi, një qendër besnike e ndikimit dhe e veprimit tonë. Shqipëria është një vend i pasur, toka dhe nëntoka e saj janë për t’u vlerësuar. Është një vend i nderit, i miqësisë dhe i besnikërisë ndaj zotimeve që merr. ... detyra dhe interesi i Francës është që të veprojë në mënyrë që sa më parë të njihet Qeveria Shqiptare dhe që kufijtë e vitit 1913 t’i caktohen përfundimisht dhe pa asnjë ndryshim Shqipërisë”.¹

Udhëtimin e dytë në Shqipëri, deputeti Godart e ndërmori më 5 maj – 4 qershor 1922. Gjatë vizitës në Shkodër, ai vijoi përkrahjen për zgjidhjen e drejtë të çështjes së kufijve veriore. Atje, ai takoi Komandantin Peré, anëtarin francez të Komisionit Ndërkombëtar të Caktimit të Kufijve, të cilit i sqaroi arsyet përse nuk duhej të pranohej ndryshimi i kufirit në lumin e Cemit, siç e kërkonin serbët, sepse nuk bëhej fjalë për disa km katrorë, por tërë fisin e Kelmendit. Ndarja e kësaj krahine nga Shqipëria përbënte një cënim të madh moral dhe dëmtonte qeverinë shqiptare. Ndërhyrja e filoshqiptarit Godart rezultoi efikase. Sipas njoftimeve të konsullit francez në Shkodër Begë-Bilëkok dhe Komandantit Peré, kufiri verior u caktua pa shumë dëme për Shqipërinë dhe fisi i Kelmendasve shpëtoi nga lënia e tokave jashtë kufirit.²

Justin Godart u interesua po ashtu për zgjerimin e bashkëpunimit shqiptaro-francez në fushën e shkëmbimeve tregtare, zhvillimit të infrastrukturës, krijimit të sistemit bankar etj. Ai synonte të nxiste sipërmarrësit francezë të investonin në Shqipëri, duke i reklamuar kushtet e favorshme klimaterike, resurset e pashfrytëzuara nëntokësore dhe mbitokësore. Grupi “Syndicat d’Etudes Franco-Albanais”, me përfaqësues Zhake kërkonte koncesionin për kërkimin dhe shfrytëzimin e naftës, duke rivalizuar me kompaninë angleze Anglo-Persian Oil dhe atë amerikane Standard Oil Company. Ndërsa, Shoqëria Fives Lille ishte e interesuar për ndërtimin e 12 urave në Shqipëri, kostoja e të cilave i tejkalonte mundësitë financiare të buxhetit vjetor. Në këto kushte, konsulli francez Begë-Bilëkok, i cili po negocionte me kryeministrin Ahmet Zogu, i propozoi shlyerjen e detyrimeve nëpërmjet dhënies me koncesion të pyjeve, monopolit të duhanit dhe të cigareve, të letërës së cigareve dhe të shkrepseve, monopolit të distilimit të alkoolit etj. Kreu i qeverisë shqiptare refuzoi t’i jepte një përgjigje definitive, sjellje kjo që krijoi pakënaqësi te diplomatët francezë. Mungesa e vendimmarrjes nga ana e ekzekutivit dhe e legjislativit shqiptar arsyetohej prej shqiptarofilit Godart “me fatalizmin dhe zvarritjet që vihen re në natyrën e shqiptarëve, si dhe frymën myslimane, të cilat, në sytë e njerëzve perëndimore, marrin pamjen e hileve, të një mashtrimi të madh. Nga ana tjetër, shqiptarët nuk e njohin fare mënyrën se si duhet të kryhen këto punë, duke pasur parasysh vendimet, veprimet dhe përgjegjësitë që ngërthejnë. Ata kanë mbetur ende në kohën e pazarllëqeve dhe të dredhive që shoqërojnë këto”.³

Pavarësisht qejfmbetjeve nga mënyra primitive e negocimit të përfaqësuesve shqiptarë, Godart nuk ndaloi së punuari për progresin ekonomik të shtetit shqiptar, duke lobuar fuqimisht edhe pranë qeverisë franceze. Ai shprehte entuziazmin e madh, në dhjetor 1922, gjatë vizitës së tretë në Shqipëri, kur i komunikoi autoriteteve vendase interesin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave të Francës, Puankaré, për ngritjen e një banke franceze në Tiranë. Misioni i tij kishte për qëllim krijimin e së parës “Dhomë Tregtie Franko-Shqiptare”. Pas kësaj, do të formohej Komiteti franko-shqiptar i Kryqit të Kuq.⁴

¹ J. Godart, *Ditarët shqiptarë...*, f. 218

² A. Papa, “Justin Godart dhe...”, f. 17

³ J. Godart, *Ditarët shqiptarë...*, f. 171-172

⁴ L. Rama, “Godar: një miqësi...”, f. 19

Në lëmin e kulturës, filoshqiptari Godart prezantoi idenë e bashkëpunimit në kërkimet arkeologjike. Ai solli në Tiranë arkeologun e njohur të Armatës së Lindjes, Leon Rey që, me Ministrin e Arsimit, Rexhep Mitrovica, si interlokutorin kryesor, punuan për përgatitjen e Konventës franko-shqiptare për kërkimet arkeologjike, që u miratua nga Parlamenti shqiptar, më 1923. Kjo marrëveshje i hapi rrugë veprimtarisë 16-vjeçare të misionit arkeologjik francez në Shqipëri, nën drejtimin e profesorit Leon Rey. Nga viti 1923 deri më 1939, ai bëri gërmime dhe zbuloi një mori skulpturash dhe objektesh të tjera antike në Apoloninë e Ilirisë.¹ Po, më 1923, Agjent Konsulli francez i dorëzoi Prefekturës së Durrësit 3 arka me porcelane të Sevrit, si dhuratë e qeverisë së tij me rastin e inagurimit të Muzeut Kombëtar shqiptar. Këto porcelane sot ruhen në Fondin Etnografik të Qendrës së Studimeve Albanologjike.²

Senatori Godart do të kthehej për të shtatën herë në Shqipëri, më 24 nëntor – 7 dhjetor 1937. I shoqëruar nga bashkëshortja e tij, ata u pritën me nderime të mëdha nga populli i qytetit të Durrësit. Të ftuar në banketin e organizuar nga Shoqëria “Gruaja shqiptare”, pas brohoritjeve “Rroftë Franca!”, “Rroftë Justin Godart!” dhe luajtjes së këngës “Marseillaise”, mbajti një fjalim të shkurtër zonja Godart. Ajo shprehu dashurinë për Shqipërinë dhe siguroi se Franca mbrojtëse e natyrshme e popujve të vegjël merre pjesë me gjithë zemër në lumturinë e një populli që feston 25 vjet Pavarësi.³ Në këtë përvjetor, me propozim të qeverisë shqiptare, Mbreti Zog I i akordoi urdhra të ndryshme veprimtarëve të shquar kombëtarë, si dhe personaliteteve të huaja që kishin ndihmuar popullin shqiptar në vitet e vështira. Midis tyre ishte edhe J. Godart, i cili u dekorua me urdhrin më të lartë shqiptar të kohës: Kordonin e Madh të Urdhrit të Skendërbeut.⁴

Gati një vit e gjysëm pas këtij celebrimi, sovraniteti dhe integriteti territorial i Shqipërisë u dhunua nga Italia fashiste. Kjo situatë shkaktoi reagimin e shqiptarëve brenda dhe jashtë vendit. Me 8 prill 1939, në sallën “Wagram”, studentët shqiptarë në Paris organizuan, brenda pak orësh, një miting kundër fashizmit. Në këtë manifestim, me ta u bashkuan edhe francezë dhe ballkanas, të cilët shprehnin të njëjtin ankth dhe solidaritetin e tyre me Shqipërinë e vvarë. Në shënimet e tij, Godart, përshkruan imazhet e asaj nate, kur studentët shqiptarë, të tubuar rreth flamurit të tyre të kuq me shqiponjën e zezë, filluan të këndonin Marsejezën.⁵

Më 26 korrik 1939, senatori Godart mori një letër nga Ali Kërcyra, i cili ishte vendosur me një grup luftëtarësh anti-zogistë në Royat, duke pritur mbështetjen e ministrit të Jashtëm të Francës. Heshnja e tij tregonte mospranimin nga ana e qeverisë së Republikës Franceze për t’i ardhur në ndihmë popullit shqiptar në gjendjen tragjike, në të cilën ndodhej. Këlcyra shprehte keqardhjen për qëndrimin indiferent të Francës para peripecive të dramës kombëtare shqiptare. Vërtet qeveria franceze nuk kishte interesa të drejtpërdrejta në Shqipëri, por si një fuqi e madhe botërore, ajo nuk mund të qëndronte mospërfillëse askund dhe sidomos në Europë. Në letrën drejtuar Godart-it, Ali Kërcyra e vinte në dijeni se çdo përkrahje që qeveria franceze do t’i jepte Zogut do të kishte impakt negativ në Shqipëri. Ai argumentonte se Ahmet Zogu nuk ishte konsideruar si sovran nga populli i tij, por si shtypës i tyre në shërbim të të huajve. Ndaj mund të pranohej, - shtonte Këlcyra, nëse ai vinte në Francë për të prishur të hollat që mori si shpërblim të tradhtisë së tij, por njohja e Zogut si përfaqësues i popullit shqiptar do të shkaktonte zemërimin e të gjithëve në Shqipëri. Atdhetarët shqiptarë shpresonin që qeveria franceze nuk do ta përsëriste edhe njëherë historinë e Esat Pashë Toptanit. Këlcyra e mbyllte letrën duke njoftuar largimin e

¹ “Kujtimet e Leon Rey: Si i zbulova skulpturat dhe objektet e tjera antike në Apoloninë e Ilirisë”, Tirana Observer, 08.02.2013, <http://www.tiranaobserver.al/kujtimet-e-leon-rey-si-i-zbulova-skulpturat-dhe-objektet-e-tjera-antike-ne-apolonine-e-ilirise/>

² Frederik Stamati, “Misteri i porcelaneve të Sevres”, *Rilindasi*, Viti II, Nr.33, E diel, 19 Gusht 2012, f. 2

³ “Miku i Madh i Shqipërisë zoti Senator Justin Godart në tokën tonë”, *Shtypi*, E mërkurë, 1 Dhjetor 1937, f. 1

⁴ J. Godart, *Ditarët shqiptarë...*, f. 205

⁵ L. Rama, “Godar: një miqësi...”, f. 19

tij nga Franca, qoftë edhe përkohësisht, dhe duke shprehur falenderimet për mbështetjen e dhënë në këto kohë plot trishtim të mërgimit në Francë.¹

Lufta e Dytë Botërore e gjeti Justin Godart-in në radhët e Frontit Nacional-Çlirimtar dhe pas çlirimit të Francës, në krye të Bashkisë së Lionit. Edhe pas Luftës, ai do të udhëhiqej nga vlerat humane dhe të solidaritetit me fatet e popujve të vegjël. Godart vijonte të shfaqte interes për gjendjen në Shqipëri. Me iniciativë të tij, më 26 shkurt 1950, u themelua shoqata e miqësisë Francë-Shqipëri. Një vit më vonë, senatori francez ndërmori udhëtimin e fundit në Shqipëri, i ftuar nga qeveria për kremtimet e përvjetorit të çlirimit. Në shënimet e tij, Godart vlerëson progresin e bërë nga shteti shqiptar, duke krahasuar situatën në vitin 1921 me atë të vitit 1951. Pa mundur të njohë dhe të kuptojë të vërtetën, Justin Godart e shihte me simpati qeverinë e re të instaluar në Tiranë, të lidhur ngushtë me Bashkimin Sovjetik.²

Para se të vdiste, ai i dhuroi të gjitha objektet shqiptare, letrat, fotografitë etj., muzeut të famshëm, Musée de l'Homme në Paris dhe një pjesë tjetër të koleksionit muzeut të qytetit të Lionit. Miku i shqiptarëve ndërroi jetë më 12 dhjetor 1956, por emri i tij u rrënjos thellë në zemrat e shqiptarëve për shërbimin e çmuar në mbrojtje të çështjes kombëtare dhe zhvillimit të qytetërimit.³

Përfundime

Senatori francez, Justin Godart, i apasionuar nga bukuritë natyrore, patriotizmi pa kompromis dhe mikpritja familjare e vëllazërore, ndërmori tetë udhëtime në Shqipëri, në periudhën mars 1921 - dhjetor 1951. Në shënimet e tij, ai përshkruan me imtësi situatën politike, gjendjen ekonomike, marrëdhëniet shoqërore dhe realitetin kulturor, që i dekurton nëpërmjet takimeve të shumta me personalitete politike apo njerëz të zakonshëm, pritjeve në institucione të ndryshme, si dhe vizitave anë e mbanë Shqipërisë. Këndvështrimi i tij mbi “vendin e shqiptarëve” iu bë i njohur opinionit publik ndërkombëtar falë botimit të veprave “Shqipëria në 1921” (1922) dhe “Ditarët shqiptarë” (2008), si dhe publikimit të një sërë artikujve në të përditshmet franceze. Kjo veprimtari e gjerë publicistike e mikut Godart i shërbeu popullit shqiptar, jo vetëm për ndryshimin pozitiv të perceptimit të huaj mbi stadin e zhvillimit të qytetërimit shqiptar, por, mbi të gjitha, për të mbrojtur të drejtat e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare.

Bibliografia

Bekteshi, B., “Dedikimi i gjetur i Justin Godart për Fishtën, ose francezi i pasionuar me Shqipërinë”, *Sot*, 26 Shtator 2013, f. 16

“Bibliografia”, *Hylli i Dritës*, Nr. 11, Nëntor 1922, f. 552

Criticus. “Tue i hjedhë një sy librit të z. Godartit “Shqypnija në vjetin 1921”, *Agimi*, Nr. 10, Shkurt 1922, f. 197

“Çë tha Z. J. Godart-i”, *Mbrojtja kombëtare*, Viti 11, Nr. 31, Vlorë, e martë, 19 Prill 1921, f.2

Godart, J. *Ditarët shqiptarë: shënimet e udhëtimeve nga marsi 1921 deri në dhjetor 1951*. Tiranë: Dituria, 2008

“Godard-i për Korçën shqiptare”, *Mbrojtja Kombëtare*, Nr. 35, Vlorë, E hënë, 23 Maj 1921, f. 1

Godart, J., “Tregim dashamirsije bujare. Shqypnija e don Francën”, *Agimi*, Vjeti III, Nr. 2, Shkodër, Qershor 1921, f. 27

Godart, J. *Shqipëria në 1921*. Tiranë: Klubi i Poezisë, 2015

Godart, J., “Shqipëria e dashuron Francën”, *Drita*, 5 qershor 1921

¹ J. Godart, *Ditarët shqiptarë...*, f. 224-225

² Ibid., f. 207-212

³ L. Rama, “Godar: një miqësi...”, f. 19

Godart, J., “Shqipëria dhe panairi i Lionit”, *Expansion Commerciale*, Nr. 13, Korrik 1921, f. 4
 Godard, J., “Shqipëria dhe Italia”, *L’Ere Nouvelle*, 22 Qershor 1921
 Godart, J., “Shqipëria është viktimë e një padrejtësie”, *Le Matin*, 1 Korrik 1921
 Godart, J., “Shqipëria ushqen dashuri për Francën”, *Jet’e Re*, 30 Qershor 1921
 “L’Albanie en 1921”, Paris, 1922. Rec. Shqypnija e miqt e sajë”, *Hylli i Dritës*, Nr. 3, Mars 1922, f. 131
 “M.J. Godard-i në Vlorë”, *Mbrojtja Kombëtare*, Nr. 30, Vlorë, E enjte, 14 Prill 1921, f. 3-4
 “Miku i Madh i Shqipërisë zoti Senator Justin Godart në tokën tonë”, *Shtypi*, E mërkurë, 1 Dhjetor 1937, f. 1
 Papa, A., “Justin Godart dhe At Gjergj Fishta”, *Gazeta Shqiptare*, Nr. 6030, 16 qershor 2016, f. 16
 Rama, L., “Godar: një miqësi e vjetër”, *Korrieri*, Nr. 91, 21 prill 2005, f. 19
 Skëndo, L., “Duke kënduar një libër: L’Albanie et les Albanias en 1921”, *Dodona*, Nr. 2, Shkurt 1922, f. 29
 Stamati, F., “Misteri i porcelaneve të Serves”, *Rilindasi*, Viti II, Nr.33, E diel, 19 Gusht 2012, f. 2

Webliografia

At Gjergj Fishta... në “Ditarët” e Justin Godart, <http://www.radiandradi.com/at-gjergj-fishta-ne-ditaret-e-justin-godart/testata-kryesore/gazeta/> , available on 22.09.2017
 Fotaq Andrea, “Justin Godart, mik i madh i kombit shqiptar”, 23.06.2012, http://www.zemrashqiptare.net/neës/id_28133/rp_0/act_print/rf_1/Printo.html
 Fotaq Andrea, “Justin Godari: Shqipëria më 1921”, 1 Gusht 2012, <http://www.nacionalalbania.al/2012/08/fotaq-andrea-justin-godari-shqiperia-me-1921/>
 “Kujtimet e Leon Rey: Si i zbulova skulpturat dhe objektet e tjera antike në Apoloninë e Ilirisë”, Tirana Observer, 08.02.2013, <http://www.tiranaobserver.al/kujtimet-e-leon-rey-si-i-zbulova-skulpturat-dhe-objektet-e-tjera-antike-ne-apolonine-e-ilirise/>